

GJYKATA E APELIT

Numri i lëndës: PAKR 102/13

Datë: 12 dhjetor 2013

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS në kolegjin e përbërë nga Gjyqtarja e EULEX-it Annemarie Meister si Kryetare e Trupit Gjykes dhe Gjyqtare Raportuese, Gjyqtari i EULEX-it Bertil Ahnborg dhe Gjyqtari Xhevdet Abazi si anëtarë të Trupit Gjykes, me pjesëmarrjen e Anna Malmström, Këshilltare Ligjore e EULEX-it, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurën penale kundër:

1. **SA**, i lindur më X 19XX në , Komuna e , i biri i **HA** dhe **SA**, shtetas i Kosovës, me vendbanim në , Komuna e , i martuar me arsim të mesëm, me profesion teknik-makinerish i gjendjes mesatare financiare.
2. **DH**, i lindur më X 19XX në , djali i **SH** dhe **GH**, shtetas i Kosovës.
3. **BS**, i lindur më X 19XX në , Komuna e , i biri i **HS** dhe **FS**, shtetas i Kosovës.
4. **SS**, i lindur më X 19XX në , Komuna e , i biri i **HS** dhe **HS**, shtetas i Kosovës, me banim në , i martuar, me arsim të mesëm, me profesion bujk i gjendjes mesatare financiare.
5. **SU**, i lindur më X 19XX në , , i biri i **UU** dhe **XU**, shtetas i Kosovës.

të akuzuar në Aktakuzën PPS 460/09 të paraqitur më 29 korrik 2011 dhe ndryshuar më 15 shtator 2011 për veprat penale në vijim, në bashkëkryerje:

Akuza 1: **SA**, **BS** dhe **SU**, *Vrasje e rëndë*, në bazë të nenit 30 (1) dhe (2) të Ligjit Penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (LPKSAK), në lidhje me nenin 22 të Kodit Penal të Republikës Federale Socialiste e Jugosllavisë (KPRSFJ), aktualisht të penalizuar sipas Neneve 146 dhe 147 (3) dhe Neni 23 i Kodit Penal të Kosovës (KPK);

Akuza 2: SA, SU, DH dhe BS, Vrasje e Rëndë në Tentativë, në bazë të nenit 30 (1) dhe (2) LPKSAK dhe nenit 19 dhe 22 KPRSFJ, aktualisht penalizohen sipas neneve 146 dhe 147 (3) KPK në lidhje me Nenin 20 dhe 23 KPK.

Akuza 3: SU, DH dhe SS, Vrasje e Rëndë në Tentativë, në bazë të nenit 30 (1) dhe (2) LPKSAK dhe nenit 19 dhe 22 KPRSFJ, aktualisht penalizohen sipas neneve 146 dhe 147 (3) KPK lidhur me nenin 20 dhe 23 KPK ;

të shpallur fajtor me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P 592/11, të datës 17 dhjetor 2012 (në tekstin vijues Aktgjykimi i kundërshtuar) si më poshtë:

SA për veprën penale Vrasje e rëndë në bashkëkryerje sipas nenit 30 (1) dhe (2) LPKSAK në lidhje me nenin 22 KPRSFJ, aktualisht dënohet sipas neneve 146 dhe 147 (3), (5) dhe / ose (11) KPK (Pika 1), i dënuar me një afat prej dymbëdhjetë (12) vjet burgim;

DH për veprën penale të Vrasjes së rëndë në tentativë, në bashkëkryerje sipas nenit 30 (1) dhe (2) LPKSAK në lidhje me nenet 19 dhe 22 KPRSFJ, aktualisht dënohet sipas neneve 146 dhe 147 (3), (5) dhe / ose (11) KPK në lidhje me nenet 20 dhe 23 KPK (Pika 3); dënuar me një afat prej shtatë (7) vjet burgim;

BS për veprën penale Vrasje e Rëndë, në bashkëkryerje sipas nenit 30 (1) dhe (2) LPKSAK në lidhje me nenin 22 KPRSFJ, aktualisht dënohet sipas neneve 146 dhe 147 (3), (5) dhe / ose (11) KPK (Pika 1), i dënuar me një afat prej dymbëdhjetë (12) vjet burgim;

SS për veprën penale të Vrasjes së Rëndë në Tentativë, në bashkëkryerje sipas nenit 30 (1) dhe (2) LPKSAK në lidhje me nenet 19 dhe 22 KPRSFJ, aktualisht dënohet sipas neneve 146 dhe 147 (3), (5) dhe / ose (11) KPK-së në lidhje me nenet 20 dhe 23 KPK (Pika 3); dënuar me një afat prej tetë (8) vjet burgim;

SU për veprën penale Vrasje e Rëndë, në bashkëkryerje sipas nenit 30 (1) dhe (2) LPKSAK në lidhje me nenin 22 KPRSFJ (Pika 1) dhe Vrasje e Rëndë në Tentativë, në bashkëkryerje sipas nenit 30 (1) dhe (2) LPKSAK në lidhje me nenet 19 dhe 22 KPRSFJ, aktualisht dënohet sipas neneve 146 dhe 147 (3), (5) dhe / ose (11) KPK, në lidhje me nenet 20 dhe 23 KPK (Pika 3), i dënuar me një afat prej katërbëdhjetë (14) vjet burgim (Pika 1) dhe nëntë (9) vite burgim (Pika 3) me dënim unik, tw përcaktuar, pesëmbëdhjetë (15) vjet burgim.

duke vepruar sipas ankesave të Mbrojtjes, avokates Fehmije Gashi-Bytyqi dhe avokatit Basri Jupolli parashtruar në emër të SU më 20 mars 2013, Avokatit Ramiz Krasniqi parashtruar në emër të DH më 21 mars 2013, Avokatit Ali Beka parashtruar në emër të BS më 21 mars 2013, Avokatit mbrojtës Haxhi Millaku në emër të SS më 25 mars 2013 dhe Avokatit mbrojtës Ilaz Kadolli parashtruar në emër të SA më 28 mars 2013 tw gjitha ankesat kundër Aktgjykimit të kundërshtuar;

pas shqyrtimit të Përgjigjes të Prokurorit të Apelit të Kosovës nr APP / I 45/13 të datës 17 maj 2013, dhe të paraqitur po në këtë datë ;

pasi ka mbajtur një seancë publike në 12 dhjetor 2013 në praninë e të akuzuarve SA dhe SS, Avokatëve Mbrojtjës Naim Qelaj (zëvendësues i Ilaz Kadollit), Ramiz Krasniqi, Ali Beka, Haxhi Millaku, Fehmije Gashi-Bytyqi dhe Basri Jupolli, të Prokurorit të Shtetit Kari Lamberg dhe palës së dëmtuar AS.

pas këshillimit dhe votimit në 12 dhjetor 2013

në bazë të neneve 420 dhe atyre në vazhdim të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK)

nxjerr si vijon këtë:

AKTGJYKIM

I. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës nr. P 592 / datë 17 dhjetor 2012 NDRYSHOHET në këtë mënyrë sipas detyrës zyrtare si në vijim:

Akuza 1: SA, BS dhe SU, secili me të dhënat personale si më lart janë gjetur fajtorë për Vrasje të Rëndë, sipas Nenit 30 (1) dhe (2) LPKSAK në lidhje me nenin 22 KPRSFJ, aktualisht dënohen sipas neneve 146 dhe 147 (3) dhe (5) KPK dhe Neni 23 KPK

Pjesa e mbetur e dispozitivit nën Akuzën 1 mbetet e njëjtë.

Akuza 3: SU, DH dhe SS, secili me të dhënat personale si më lart janë gjetur fajtorë për Vrasje të Rëndë në Tentativë, sipas Nenit 30 (1) dhe (2) LPKSAK dhe nenet 19 dhe 22 KPRSFJ, aktualisht dënohen sipas Neneve 146 dhe 147 (5) KPK, në lidhje me nenet 20 dhe 23 KPK.

Pjesa e mbetur e dispozitivit sipas Akuzës 3 mbetet e njëjtë.

II. Ankesat e Mbrojtësve, Ramiz Krasniqi parashtruar në emër të DH më 21 mars 2013, Avokatit Ali Beka parashtruar në emër të BS më 21 mars 2013 dhe Avokatit Haxhi Millaku parashtruar në emër të SS në 25 mars 2013 janë në këtë mënyrë të aprovuara pjesërisht.

III. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës nr. P 592/11 të datës 17 dhjetor 2012 NDRYSHOHET me anë të kësaj, në bazë të ankesave të paraqitura në emër të DH, BS dhe SS dhe sipas detyrës zyrtare në lidhje me SA dhe SU, si vijon:

Në bazë të nenit 391 (5) KPPK dënimet e shqiptuara do të përfshijnë kohën që të pandehurit kanë kaluar në paraburgim deri në shqiptimin e dënimeve me burgim të shkallës të parë dhe përcaktimin e ankesave.

IV. Arsyet e tjera të ankesave të Mbrojtjes në këtë mënyrë janë hedhur poshtë si të pabazuara dhe pjesa e mbetur e Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës P 592/11 të datës 17 dhjetor 2012 është konfirmuar.

ARSYETIMI

I. Historia procedurale e rastit

1. Aktakuza në këtë rast, PPS 460/09, është paraqitur më 29 korrik 2011 dhe më vonë ndryshuar më 15 shtator 2011. Me aktakuzë të pandehurit janë akuzuar për veprat penale të përmendura më lart. Aktakuza u konfirmua më 6 tetor, 2011

2. Shqyrtimi gjyqësor filloi më 3 shkurt 2012 para kolegjit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë i përbërë nga dy gjykatës të EULEX-it dhe një gjykatës i Kosovës. 43 seanca janë mbajtur gjatë gjithë vitit 2012 deri sa gjykimi ka përfunduar më 14 dhjetor 2012. Më 17 dhjetor 2012, është shpallur aktgjykimi dhe ku të pandehurit janë shpallur fajtorë për veprat penale të përmendura më lart. Trupi Gjykues ka ndryshuar më tej kualifikimin ligjor të pikës 2 të aktakuzës në Rrëmbim në tentativë, sipas Nenit 164 (1) KPRSFJ në lidhje me nenet 19 dhe 22 KPRSFJ, aktualisht si vepra penale në bazë të nenit 159 (1) KPK në lidhje me nenet 20 dhe 23 KPK. Trupi Gjykues hodhi poshtë akuzën nën pikën 2 për shkak të skadimit të afatit të parashkrimit.

3. Ankesat e mëposhtme janë parashtruar me kohë: më 20 mars 2013 nga Avokatët Fehmije Gashi-Bytyqi dhe Basri Jupolli në emër të **SU**, më 21 mars 2013 nga Avokati Mbrojtës Ramiz Krasniqi në emër të **DH** dhe Avokati Mbrojtës Ali Beka në emër të **BS**, më 25 mars 2013 nga Avokati Mbrojtës Haxhi Millaku në emër të **SS** dhe më 28 mars 2013 nga Avokati Ilaz Kadolli në emër të **SA**.

4. Prokurori Special paraqet një përgjigje ndaj ankesave më 26 prill 2013 dhe mendimi i Prokurorit Apelit është dorëzuar më 17 maj 2013.

II. Paraqitjet e palëve

1. Ankesa e SA

5. Avokati Mbrojtës Ilaz Kadolli sfidon Aktgjykimin e kundërshtuar në emër të **SA** për arsyet e mëposhtme:

- Shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale, neni 384 (1) pika 1.12 LPP
- Vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, neni 386 (1), (2) dhe (3) LPP
- Vendimi mbi dënimin, neni 387 të LPP

Avokati mbrojtës i propozon Gjykatës së Apelit ta anulojë aktgjykimin kundërshtuar dhe të lirohet **SA**, ose për t'u kthyer lënda në rigjykim. Avokati Mbrojtjes paraqet në vijim.

6. Dispozitivi i Aktgjykimit të Kundërshtuar është i pakuptueshëm dhe në kundërshtim me arsyetimin dhe përmbajtjen e aktgjykimit. Asnjë prej veprimeve të **SA** në vrasje nuk është provuar dhe as justifikohen me të dhëna apo përmbajtjen e dokumenteve në shkresat e lëndës. Dëshmia e **NB** nuk vërtetohet me provat e anëtarëve të familjes së viktimës. Më tej, Gjykata nuk e ka miratuar propozimin e mbrojtjes për një ekzaminim psikologjik të **NB** edhe pse ka pasur shumë shenja të problemeve shëndetësore. Ai u trajtua në një institucion privat neuropsikiatrik.

7. **SA** është i bindur se gjendja faktike është krejtësisht e ndryshme nga ajo e përshkruar në aktgjykim. Aktgjykimi është krejtësisht i bazuar në deklaratën e dëshmitarit bashkëpunues. Asnjë prej dëshmitarëve të tjerë nuk kanë konfirmuar ose vërtetuar pjesëmarrjen e **SA**. **NB** ishte i vetëdijshëm se **SA** ishte një biznesmen i suksesshëm, ai ka në pronësi të vetën pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme me vlerë të madhe dhe ai ka pasur kontakte biznesi me **FG**. Ky është motivi kryesor pse **NB** implikon **SA**. Dëshmitarët e Prokurorisë **MI** dhe **ST** nuk janë të besueshëm. Ata janë tejet të njohur nga organet gjyqësore si përsëritës të veprave penale dhe ata kanë qenë të dënuar për kërcënime nga gjykatat e Ferizaj dhe të Prishtinës për vepra të ndryshme penale. Prokuroria nuk arriti të ofrojë dëshmi për sa i përket raporteve të mjekësisë ligjore ose të autopsisë për të krijuar rrethanat e vrasjes. Katër dëshmitarët e mbrojtjes të dëgjuar, provuan se **SA** kishte një alibi. Ai ishte në një festë për djalin e tij në kohën e vrasjes.

8. Dënimi me 12 vjet burgim është një dënim i lartë dhe i pabazuar.

2. Ankesa e DH

9. Avokati Mbrojtës Ramiz Krasniqi sfidon Aktgjykimin e kundërshtuar në emër të klientit të tij, **DH** mbi bazat si në vijim:

- Shkelje thelbësore e dispozitave të procedurës penale, neni 403 (1) pika 12, KPPK
- Përcaktim i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike, neni 405 (2), KPPK
- Shkelje e ligjit penal, neni 404, KPPK
- Vendimi mbi dënimin

Avokati Mbrojtës propozon që Gjykata e Apelit të ndryshojë Aktgjykimin e kundërshtuar dhe të lirojë **DH** për shkak të mungesës së provave. Avokati Mbrojtës gjen si në vijim.

10. Dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm dhe në kundërshtim me përmbajtjen dhe arsyetimin e aktgjykimit. Përshkrimi i fakteve inkriminuese është i paqartë, që gjë sjellë në sipërfaqe shumë dilema lidhur me aktivitetet e **DH**. Nuk dihet se kur ka ndodhur ngjarja.

11. Pjesa e arsyetimit në aktgjykim nuk përmban faktet vendimtare dhe nuk ka vlerësim të provave kundërshtuese. Pjesa e arsyetimit në aktgjykim nuk përputhet me dispozitivin. Është e pamjaftueshme t'u falet besimi dëshmitarëve të vetëm dy dëshmitarëve. Këto dy dëshmi nuk përputhen me njëra-tjetrën dhe gjykata u shmanget mospërputhjeve. Nuk ka prova për të dëshmuar pjesëmarrjen e **DH** dhe nuk i dimë saktë veprimet e tij në këtë ngjarje. Prandaj, situata faktike nuk është konfirmuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë.

12. Gjykata gjeti se **AS** veproi në vetëmbrojtje. Për të konfirmuar vetë-mbrojtjen është dashur të nisen procedura penale ndaj tij. Vetëm nëpërmjet procedurave penale mund të konfirmohet veprimi në vetë-mbrojtje.

13. Vendimi mbi dënimin është i rëndë, nuk është arsyetuar siç duhet dhe nuk është në një linjë me praktikën. Koha e kaluar nga **DH** në paraburgim nuk është llogaritur në dënim.

3. Ankesa e **BS**

14. Avokati Mbrojtës Ali Beka sfidon Aktgjykimin e kundërshtuar në emër të **BS** mbi bazat si në vijim:

- Shkelje thelbësore e dispozitave të procedurës penale, neni 403, KPPK
- Shkelje e ligjit penal, neni 404, KPPK
- Përcaktim i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike
- Vendimi mbi dënimin

Avokati Mbrojtës propozon që Gjykata e Apelit të ndryshojë Aktgjykimin e kundërshtuar dhe të lirojë **BS** apo të anulojë aktgjykimin dhe të kthejë lëndën në rigjykim. Avokati Mbrojtës gjen si në vijim.

15. Dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm dhe në kundërshtim me përmbajtjen dhe arsyetimin e aktgjykimit, dhe është i bazuar në prova të përzgjedhura dhe të insertuara. Dëshmitarët e dëgjuar nuk ishin të saktë apo të korrektë dhe nuk kanë dhënë baza për të gjetur se **BS** mori pjesë në veprën penale. Derisa Gjykata po arsyetonte se në cilat raste nuk i falë besimin **NB**, vetëm konfirmoi kundërshtimet e arsyetimit të aktgjykimit me përfundime dhe sqarime më shumë teorike se sa prova vlerësuese të besueshmërisë së tyre. Gjykata nuk jep sqarime lidhur

me pretendimet e mbrojtjes për gjendjen e shëndetit mendor të **NB**, problemet e tij familjare, etj. Gjykata u përpoq të zvogëlojë kundërthëniet nëpërmjet sqarimeve teorike.

16. Arsyetimi i Aktgjykimit të kundërshtuar nuk përputhet as me dispozitivin për shkak se në dispozitiv Gjykata thotë se **BS** është shpallur fajtor për Vrasje të Rëndë, neni 30 (1) dhe (2) LPKSAK lidhur me nenin 22, KPRSFJ, tani ndëshkueshëm me nenet 146 dhe 147 (3) (5) dhe (11) dhe neni 23, KPP ndërsa arsyetimi i aktgjykimit se Gjykata konsideron kualifikimin më të pranueshëm të Vrasjes sipas nenit 30, para. 2, nënpara. 1, LPKSAK/ neni 147, pika 3, KPK. Kualifikimi ligjor i akuzës 1 është në kundërthënie me parimin e ligjshmërisë se duket thuajse **BS** shpallet fajtor për që të dyja, veprën penale Vrasje nga neni 30 (1) LPKSAK dhe për veprën penale Vrasje e rëndë nga neni 30 (2) LPKSAK.

17. Aktgjykimi i kundërshtuar bazohet në vetëm një dëshmitar, i cili është edhe dëshmitar bashkëpunues, pa u mbështetur në asnjë provë tjetër, gjë që përbën shkelje të nenit 157 (1) dhe (4), KPPK. Gjykata mori më tutje në pyetje dëshmitarin **KV**, dëshmitar të privilegjuar, pa u liruar nga organi kompetent. Në deklaratën e tij, ai shkeli detyrën e privatisë së fshehtësive zyrtare dhe ushtarake duke dhënë dëshmi, në shkelje të nenit 403 (2), pika 1 lidhur me nenin 159 (1), KPPK.

18. Nga perspektiva e situatës faktike, është shumë e vështirë të vlerësohet Aktgjykimi i kundërshtuar për shkak se nuk përmban arsyetim të vlefshëm por vetëm sqarime teorike lidhur me vlerësimin e provave. Kur i është dhënë **NB** statusi i dëshmitarit bashkëpunues kishte një shkelje ligjore. Statusi i është dhënë atij pa iu nënshtruar ai ndonjë ekzaminimi të përgjithshëm dhe ne nuk mundemi dhe nuk duhet t'i falim besimin atij. Asnjë nga dëshmitarët e prokurorisë nuk ishin dëshmitarë të drejtëpërdrejtë apo rrethorë, gjë që do të thotë se asnjë prej tyre nuk ka dhënë kontributin më të vogël për të konfirmuar për të konfirmuar situatën faktike.

19. Derisa solli vendimin për dënim, Gjykata konsideroi si rrethanë rënduese kualifikimin e veprës penale si Krim të organizuar. Gjatë kualifikimit të veprës si krim të organizuar, Gjykata tejkaloi kompetencat e saj ligjore. Më tutje, gjatë sjelljes së dënimit, Gjykata nuk llogariti kohën e kaluar në paraburgim.

4. Ankesa e SS

20. Avokati Mbrojtës Haxhi Millaku sfidon Aktgjykimin e kundërshtuar në emër të SS mbi bazat si në vijim:

- Shkelje thelbësore e dispozitave të procedurës penale, neni 403, KPPK
- Shkelje e ligjit penal, neni 404, KPPK
- Përcaktim i gabuar dhe jo i plotë i situatës faktike
- Vendimi mbi dënimin

Avokati Mbrojtës propozon që Gjykata e Apelit të ndryshojë Aktgjykimin e kundërshtuar dhe të lirojë SS apo të anulojë aktgjykimin dhe të kthejë lëndën në ri-gjykim. Avokati Mbrojtës gjen si në vijim.

21. Dispozitivi i Aktgjykimit të kundërshtuar është i paqartë dhe në kundërthënie me përmbajtjen dhe arsyetimin e ofruar. Nuk është i bazuar në prova të përzgjedhura dhe të prezantuara, por në rrëfimin e vetëm një personi. Gjykata ka ofruar arsye se përse në disa raste i falë besimin **NB** dhe në cilat jo, gjë që vetëm konfirmon kundërthëniet në aktgjykim, dhe gjetjet dhe sqarimet janë më shumë teorike sesa vlerësime të vërteta të provave. Gjykata ka gjetur se ka papërputhshmëri në deklaratat e **NB**.

22. Janë shkelur dispozitat e nenit 157 (1) dhe (4), KPPK, për shkak se Aktgjykimi i kundërshtuar bazohet në vetëm një dëshmitar, dëshmitar bashkëpunues dhe në asnjë provë tjetër. Përpos kësaj, Gjykata ka shkelur edhe nenin 403 (2), pika 1, KPPK lidhur me nenin 159 (1), KPPK duke marrë në pyetje dëshmitarin **KV** pa u liruar nga organi kompetent. Ai mund të ketë shkelur detyrën e tij për të mbajtur fshehtë fshehtësisë zyrtare dhe ushtarake. Të drejtat e të pandehurit janë shkelur për shkak se Gjykata nuk ka ftuar dëshmitarin e propozuar nga mbrojtja pasi që dëshmitari **KV** ka dhënë një emër.

23. Nga perspektiva e situatës faktike, është shumë vështirë të vlerësohet Aktgjykimi i kundërshtuar për shkak se nuk përmban arsyetim të vlefshëm por vetëm sqarime teorike lidhur me vlerësimin e provave. Nuk ka pasur prova materiale përpos atyre në favor të mbrojtjes siç ishte prova që **NB** kishte nënshkruar se i kishte borxh **SS** €84 000. E vetmja arsye për të cilën **NB** po e akuzonte këtë ishte që të mos detyrohej të kthente borxhin. Nuk duhet që një dëshmitar të shpallet bashkëpunues pa iu nënshtruar ky një ekzaminimi të përgjithshëm (personalitetit, të kaluarës, gjendjes së tij mendore, etj.). **NB** nuk është dëshmitar i besueshëm. Ky është një person me probleme të shëndetit mendor, i zhytur në çështje biznesi me partnerë në borxhe të mëdha dhe i dëbuar nga familja e tij për një varg arsyesh.

24. Kualifikimi ligjor i akuzës 3 është në kundërthënie me parimin e ligjshmërisë. Me kundërthëniet në mes të arsyetimit dhe dispozitivit mbi kualifikimin ligjor, Gjykata ka bërë një interpretim analog të dispozitave të KPPK-së. **SS** është shpallur fajtor për veprën penale, neni 30 (1) dhe (2) LPKSAK lidhur me nenin 19 dhe 22, KPRSFJ që përputhet me nenin 146 dhe 147 (3), KPK lidhur me nenin 20 dhe 23, KPK. Sipas këtij kualifikimi ligjor, duket se **SS** është fajtor për që të dyja, veprën penale Vrasje e rënde dhe veprën penale Vrasje sepse paragrafi 1 i nenit 30 do të thotë vrasje e zakonshme, që përputhet me Vrasje, neni 146, KPK ndërsa paragrafi 2, neni 30 do të thotë Vrasje e rënde në tentativë, që përputhet me nenin 147 (3), KPK lidhur me nenin 20 dhe 23, KPK. Nuk mund të kemi që të dyja, Vrasje në tentativë dhe Vrasje të rënde në tentativë, por njëren ose tjetrën.

25. Gjatë vendimit mbi dënimit, Gjykata gaboi në vlerësimin si rrethanë të rënduar karakteristikën e “të qenurit grup i organizuar kaq mirë”. Këtë e konsideroi si rrethanë rënduese

dhe si Krim të organizuar. Gjatë kualifikimit si Krim të organizuar, Gjykata tejkaloj fuqinë e saj ligjore ngase Krimi i organizuar nuk gjendet në aktakuzë.

26. Më tutje, Gjykata poashtu ka shkelur ligjin penal duke mos llogaritur në dënim kohën që **SS** kaloi në paraburgim. Në Kosovën e pasluftës, askush nuk është dënuar me tetë vjetë burgim në një lëndë ku nuk ka dëm, nuk ka lëndim trupor dhe nuk ka prova materiale apo fakte.

5. Ankesa e SU

27. Avokatët Mbrojtës Fehmije Gashi-Bytyqi dhe Basri Jupolli sfidojnë Aktgjykimin e kundërshtuar në emër të **SU** mbi bazat si në vijim:

- Shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale
- Shkelje e Kodit Penal të Kosovës
- Përcaktim i gabuar dhe jo i plotë i situatës faktike
- Vendimi mbi dënimin

Avokatët Mbrojtës propozojnë që Gjykata e Apelit të ndryshojë Aktgjykimin e kundërshtuar dhe të shpallë **SU** të pafajshëm apo të kthejë lëndën në gjykatën e shkallës së parë për rishqyrtim apo rigjykim. Avokatët Mbrojtës gjejnë si në vijim.

28. Aktgjykimi bazohet në prova të papranueshme për shkak se Gjykata i falë besimin dëshmitarit bashkëpunues **NB**. Që nga fillimi i procedurës penale, mbrojtja kundërshtoi shpalljen e **NB** dëshmitar bashkëpunues, por Gjykata nuk i mori parasysht kërkesat. **NB** jo vetëm që është shpallur dëshmitar bashkëpunues, por deklaratat e tij shërbyen si provat më relevante dhe të vetmet mbi të cilat Gjykata bazoi aktgjykimin. Kjo gjë përbën shkelje të nenit 157, KPPK. Mbrojtja propozoi një ekzaminim mjekësor të **NB** për të përcaktuar gjendjen e tij mendore si dhe vendimin që deklaratat e tij të shpallen prova të papranueshme, por Gjykata nuk i mori parasysht këto.

29. Përmbajtja e aktgjykimi karakterizohet me kundërthënie të qarta, paqartësi, mospërputhje të mëdha si dhe të meta të tjera që e bëjnë aktgjykimin të paqëndrueshëm dhe me gabime logjike dhe semantike. Gjykata ka bërë shkelje thelbësore duke mos ndarë mjaftueshmërisht dhe duke mos kualifikuar qartë provat. Deklaratat e **NB** karakterizohen me mospërputhje, kundërthënie, pretendime të pasakta, huti dhe etiketime të tjera negative.

30. Janë shkelur dispozitat e KPK-së sepse në asnjë mënyrë aktet e **SU** nuk manifestojnë elementet e veprës penale Vrasje e rëndë. Nuk kishte asnjë provë që përcakttoi rolin e **SU** dhe për asnjë akuzë Gjykata nuk kishte prova për të përcaktuar rolet e veçanta të secilit të akuzuar. Asnjë nga të akuzuarit e tjerë apo dëshmitarët e prokurorit nuk pretenduan pjesëmarrjen e **SU**.

31. Dënimi është plotësisht i paligjshëm dhe i paarsyeshëm për shkak se në mungesë të provave materiale është sjellur një dënim i tillë kaq i lart për një vepër penale të cilën **SU** nuk e kreu.

6. Përgjigja e Prokurorit Special

32. Në përgjigjen e tij, Prokurori Special gjen se Aktgjykimi i kundërshtuar është plotësisht i kuptueshëm, i qartë dhe i saktë. Në mënyrë të saktë përshkruan faktet që Gjykata i vlerësoi si të dëshmuara përtej dyshimit të bazuar. Trupi Gjykues solli një analizë shumë të detalizuar të dëshmisë së **NB** dhe sqaroi në mënyrë shumë të qartë dhe koncize pse ky duhet konsideruar dëshmitar i besueshëm. **NB** ka inkriminuar veten e tij në vepra penale të ndryshme në një çast kur fare nuk kishte hetime ndaj tij. Deklaratat e tij të detalizuara, duke qenë të logjikshme, të besueshme dhe të konfirmuara, tregojnë se ai vërtetë ka qenë i pranishëm gjatë kryerjes së veprave penale. Aktgjykimi i kundërshtuar në mënyrë të saktë i është qasur të gjitha rrethanave relevante lidhur me faktet e përshkruara në aktakuzë dhe përmban arsye specifike mbi arsyen pse janë dëshmuar këto rrethana.

7. Përgjigja e Prokurorit i Apelit

33. Prokurori i Apelit propozon që Gjykata e Apelit të vlerësojë korrektësinë e përfshirjes në llogaritjen e dënimit për **SU** rrethanat rënduese të paraparë në nenin nenin 30 (3) LPKSAK, konsideruar të barabartë me nenin 147, pika 11, KPK, për të llogaritur në dënimin e caktuar kohën e kaluar në paraburgim nga të pandehurit, të hedhë poshtë të gjitha bazat e tjera për ankesa dhe të konfirmojë Aktgjykimin e kundërshtuar.

34. Prokurori i Apelit parashtron se ai e ndanë mendimin e trupit gjykues që e ka konsideruar si të tërë materialin e provave që është paraqitur para gjykatës dhe kjo është e mjaftueshme në përcaktimin e fajësisë ndaj të pandehurve mbi dyshimin e bazuar. Paneli mjaftueshëm dhe pozitivisht ka vlerësuar çështjen e besueshmërisë së **NB**. Deklaratat e **NB** janë konfirmuar me dëshmi të drejtpërdrejtë dhe rrethanore. Ne veçanti, deklaratat e tij janë konfirmuar me dëshmi të drejtpërdrejtë të dhëna nga dëshmitarët **DK**, **AK** dhe **AS** sa i përket sjelljes së kryerësve të veprës penale dhe gjate fazës së veprimeve penale. Prokurori i Apelit e ndanë vështrimin e trupit gjykues rreth gjasave të vogla të falsifikimit që në mënyrë direkte apo indirekte do të përshtatej në mënyrë të përkryer me dëshminë në akuzën 1 dhe akuzën 3 dhe kjo do të shkonte deri në atë masë që në mënyrë të panevojshme do ta atribuonte veten në rolin e kryesit direkt të veprës penale të përshkruar në akuzën 1. Avokati mbrojtës dhe të pandehurit e kanë kufizuar veten në falsifikimin e deklaratës së **NB** në vend të paraqitjes së dëshmisë së prekshme në vend të disa alibive që kanë dalë si të pavërteta dhe/ose të pa-vërtetuara.

35. Ne çështjen e provueshmërisë së deklaratës së **KV**, Prokurori i Apelit e ndanë mendimin e Prokurori Special të shprehur gjatë shqyrtimit kryesor që trupi gjyqësor e ka njërin nga dy opsionet; që dëshmitari i privilegjuar ose duhet të jetë i autorizuar nga një organ i autorizuar të japë dëshmi ose nuk duhet të ekzaminohet fare. Nuk është parapare asnjë mundësi e trete në kodin penal. Sido që të jetë, Prokurori i Apelit e ndanë vështrimin se Paneli se besueshmëria e **NB** nuk është ndikuar nga pasiguria e provave në lidhje me involvimin e pretenduar të SHIK-ut në ngjarjet në fjalë.

36. Prokurori i Apelit pajtohet me Panelin se vrasja e **IK** është kryer me paramendim siç është treguar me faktin të pandehurit kanë vepruar si grup pas përgatitjes dhe planifikimit të kahershëm paraprak të vrasjes. Vrasja është kryer në prezencë të bashkëshortes së viktimës dhe në shtëpi të viktimës-vend ku njeriu zakonisht ndihet i sigurt dhe vend ku njeriu e zvogëlon alarmimin e tij/saj. Prokurori i Apelit është i mendimit se deklaratat e **NB** në lidhje me ngjarjet e datës 6 gusht 1999 janë konsistente, të detajuara, të besueshme, logjike pa asnjë kontradiktë dhe ato mbështeten me dëshmitë e dëshmitarëve **DK** dhe **AK**, me alibinë e pa-vërtetuar të **SA** si dhe me deponimet e **MI** dhe **ST**.

37. Në lidhje me akuzën 3 Prokurori i Apelit pajtohet me trupin gjyqësor se aktet për të cilat janë shpallur fajtor të pandehurit përbejnë një tentim të organizuar mirë dhe të planifikuar së tentim vrasjes nga një grup personave të pajisur mirë dhe që kanë pasur në dispozicion kohë dhe materialin mbështes të nevojshëm. Vepra penale është kryer me paramendim e gjithashtu është kryer të fshehtë; duke e monitoruar viktimën për afro dy muaj dhe duke e përgatitur kurthin duke i përdorur dy vetura, njëra nga të cilat e ka pasur qëllimin ta ngadalësojë apo ta ndalë veturën e viktimës gjersa tjetra është ndalur në mënyrë që të mundësojë **SS** të shtije me armë. Prokurori i Apelit është i mendimit se deklaratat e **NB** në lidhje me ngjarjet e datës 12 qershor 2012 janë konsistente, të besueshme, logjike pa kurrfarë kontradiktë të rëndësishme dhe vërtetohet me dëshminë e **AS** dhe me alibitë e falsifikuara të **SS** dhe **SU** si dhe me deponimet e **MI** dhe **ST**.

38. Prokurori i Apelit është i mendimit se dënimet e shqiptuara mbi të pandehurit në përgjithësi janë adekuate për rolin e luajtur nga secili i pandehur si dhe për natyrën dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale. Në llogaritjen e dënimit trupi gjyqësor në mënyrë korrekte e ka marrë parasysh faktin se shkelja e përshkruar e Akuzës 1 dhe 3 kanë qenë të organizuara mirë dhe të kryera nga të pandehurit që kanë vepruar si një grup i pajisur mirë dhe i strukturuar në baza të një hierarkie dhe lidhshipi mirë të definuar duke pasur në dispozicion kohe, armë dhe vetura të mjaftueshme për të monitoruar palët e dëmtuara për një kohe paraprake të gjatë në mënyrë që të përgatiten dhe planifikojnë dhe ekzekutojnë krimet.

39. Duke ju referuar specifikisht të pandehurit **SU**, Prokurori i Apelit cekë se trupi gjyqësor i referohet dispozitës së nenit 30 (3) LPKSAK i cili, sipas mendimit të Panelit, do të lejonte aplikimin e rrethana të cekura edhe në rastet si kjo ku të pandehurit janë shpallur fajtor për Vrasje të Rende dhe Vrasje të Rende në Tentative. Prokurori i Apelit nuk e ndanë atë vështrim. Neni 30 (3) parasheh rrethanat renduese të kryerjes së qëllimshme të dy apo me shumë vrasjeve

si ngjarje te përfunduar te cilat kane rezultuar ne vdekjen e viktimave. Ne vend te kësaj, dispozita e aplikueshme ne një rast si ky ku nuk janë gjetur lidhje te dukshme ndërmjet vrasjes se rende dhe vrasjes se rende ne tentative duket se neni 48 KPRSFJ qe merret me situatë kur kryesi i veprës penale , me një apo me shume akte, kryen disa vepra penale për te cila ai apo ajo gjykohet ne te njëjtën kohe. Varet nga Gjykata e Apelit te vendose a duhet te ndryshohet dënimi i shqiptuar duke u bazuar ne paraprirje.

III. Zbulimet e Gjykatës se Apelit

1. Kompetencat e Gjykatës se Apelit

40. Gjykata e Apelit është gjykatë kompetente për te vendosur mbi Ankesa sipas nenit 17 dhe 18 te Ligjit mbi Gjykatat (Ligji nr. 03/L-199).

41. Paneli i Gjykatës se Apelit përbehet sipas Nenit 19 paragrafi (1) I Ligjit mbi Gjykatat dhe Nenit 3 te Ligjit mbi kompetencat, caktimin dhe alokimin e lendeve Gjyqtarëve dhe Prokuroreve te EULEX-it ne Kosove (Ligji nr. 03/L-053).

2. Ligji i aplikueshëm

42. Ligji i procedurës penale i aplikueshëm ne këtë lende penale është Ligji (i vjetër) i Kodit te Procedurës Penale qe ka mbetur ne fuqi deri me 31 dhjetor 2012 (KPPK).¹ Interpretimi i duhur i dispozitave tranzitore te Kodit (te ri) te Procedurës Penale te Kosovës, ne fuqi qe nga 1 janari 2013 pohon se ne procedurat penale te filluara para hyrjes ne fuqi te Kodit te Ri, për te cilin vetëm ka filluar gjykimi kryesor por qe nuk ka përfunduar me vendim përfundimtar, dispozitat e KPPK do te aplikohen *mutatis mutandis* deri sa vendimi te mere formën e prere. Reference ne këtë çështje iu është bere mendimit ligjor nr. 56/2013 te Gjykatës Supreme te Kosovës, i miratuar ne seancën e përgjithshme me 23 janar 2013.

43. Ne lidhje me ligjin penal te aplikueshëm Gjykata e Apelit pajtohet me ZBULIMET E Gjykatës se Qarkut qe ligji me i favorshëm dhe kështu me i aplikueshëm është Ligji Penal i KSAK (LPKSAK) me dënim maksimal për Vrasje te Rende prej 15 vjet burgim.

3. Zbulimet mbi meritat

3.1. Shkelje substanciale e Dispozitave te Procedurës Penale

44. Gjykata e Apelit heton se nuk ka pasur shkelje te dispozitave te procedurës penale.

¹ KPP, ne fuqi nga 06.04.2004 deri me 31.12.2012.

45. Gjykata e Apelit heton se dispozitivi i Aktgjykimit të atakuar është e qarte. Ajo i ceke të gjitha detalet relevante të nevojshme dhe të kërkuara me ligj, Neni 391 i KPPK. Gjykata e Apelit me tutje e konkludon të qarte arsyetimin e aktgjykimit. Aktgjykimi duhet të lexohet në tërësi në kontekstin e saj dhe vetëm kur të lexohet në tërësinë e saj atëherë diskrepancat dhe/apo mospërputhjet që e bëjnë dispozitivin të pakuptimte mund të deklarohet aktgjykimi si i paligjshëm dhe të anulohet.² Mbrojtja pretendon se Aktgjykimit të atakuar i mungojnë faktet vendimtare apo vlerësimet e provave kontradiktore. Gjykata e Apelit nuk pajtohet. Paneli i Gjykatës së Qarkut i ka vlerësuar të gjitha provat edhe nëse çka është pare si relevante është referuar në aktgjykim. Besueshmëria e **NB** dhe dëshmitarëve provues është përshkruar në aktgjykim. Mospërputhjet dhe diskrepancat në deklaratat e tyre janë adresuar. Gjithashtu edhe provat si deklaratat e të pandehurve dhe alibitë e dëshmitarëve janë adresuar dhe janë adresuar në aktgjykim.

46. Aktgjykimi i atakuar nuk bazohet në prova të papranueshme. Mbrojtja ka argumentuar se deklaratat e **NB** janë të papranueshme dhe se ky pretendim i Mbrojtjes gjatë shqyrtimit kryesor nuk është shqyrtuar nga Trupi Gjykses. Gjykata e Apelit nuk pajtohet me këtë. Pranueshmëria e provave, në veçanti deklaratat e **NB**, është konsideruar nga Trupi Gjykses i Gjykatës së Qarkut me 2 mars 2012 dhe me 13 prill 2012. Trupi Gjykses i ka marrë deklaratat si të pranueshme. **NB** është deklaruar si dëshmitar bashkëpunues para fillimit të shqyrtimit kryesor në këtë lende. Nuk është mbuluar me Aktgjykimin e kundërshtuar dhe prandaj nuk mund të nënshtrohet rishqyrtimit të Gjykatës së Apelit për ankesave në këtë rast. Gjykata e Apelit nuk ka hetuar baza ligjore për të deklaruar deklaratat si të pranueshme. Mbrojtja ka argumentuar se **NB** është i pabesueshëm por kjo është një çështje tjetër se a janë deklaratat e tij të pranueshme apo jo. Pa-pranueshmëria e deklaratave të dëshmitarëve është e rregulluar me nenin 161 KPPK dhe vetëm kur ligji në mënyrë eksplicite përshkruan në atë mënyrë, deklaratat e dëshmitarëve janë të pranueshme, pa marrë parasysh se a ka pasur dëshmitari statusin e dëshmitarit të mbrojtur apo jo, neni 153 KCCP.

47. Mbrojtja me tutje pretendon shkeljen e nenit 157 (1) dhe (4) të KPPK sepse Aktgjykimi i kundërshtuar është bazuar vetëm në një dëshmitar të vetëm. Vlerësimi i Gjykatës së Apelit është se Aktgjykimi i kundërshtuar nuk është i bazuar vetëm në një deklaratë të dëshmitarit. Të dy akuzat janë vërtetuar nga dëshmitarë tjerë dhe me prova forenzike. Mbrojtja nuk ka argumentuar përse është shkelur neni 157 (1) KPPK. Gjykata e Apelit nuk ka gjetur asnjë dëshmi apo prove tjetër të cilën mbrojtja nuk ka qene në gjendje ta sfidoje.

48. Kërkesa për ekzaminim mjekësor e **NB** është shqyrtuar nga Trupi Gjykses I Gjykatës së Qarkut me 3 mars 2012, në kundërshtim me atë çka pretendon mbrojtja. Çështja gjithashtu është mbuluar në detale në Aktgjykimin e kundërshtuar. Trupi Gjykses ka hetuar se nuk ka pasur ndonjë indikacion se ai nuk ka qene person në kontroll të arsyeshme të vetes. Gjykata e Apelit

² Për argumente të ngjashme shiko Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës me 12 Prill 2010 (Pkl-Kzz 114/09) dhe me 27 Nentor 2012 (Ap-Kz. 314/2012).

nuk sheh kurrfarë arsye ta beje ndonjë vlerësim tjetër përveç asaj që e ka bërë Trupi Gjykoës i Gjykatës së Qarkut. **NB** ka qene i pranishëm gjatë disa ditëve në shqyrtimin kryesor duke dhënë dëshmi të gjata në detaje. Nuk ka asgjë në sjelljet e tij gjatë shqyrtimit kryesor apo që rrjedh nga dëshmitë e tij që ta beje Gjykatën e Apelit të dyshojë me vlerësimin e Trupit Gjykoës.

49. Gjykata e Apelit heton se shkelja e nenit 159 të KPPK është kryer kur **KV** është marrë në pyetje pa qene i liruar nga trupi kompetent. Në vendimin e saj të datës 17 tetor 2012, Trupi Gjykoës i Gjykatës së Qarkut ka zgjedhur që mos të marrë një qëndrim mbi legjitimitetin e SHIK-ut por ka deklaruar se ka qene e hapur ndaj mundësisë së sekreteve zyrtare dhe ushtarake. Gjykata e Apelit e ndanë vështrimin e Prokurorisë së në një rast të tillë dëshmitari në fjale mund të mos merret fare në pyetje. Prandaj, Gjykata e Apelit nuk e shtjellon me këtë me tutje. Mbrojtja si baze për ankesa ka argumentuar se Gjykata e Qarkut e ka shkelur Nenin 403 (2) pika 1 në lidhshmëri me nenin 159 (1) KPPK sepse Gjykata ka ngelur të aplikojë apo për të aplikuar në dispozitën në mënyre korrekte. Në mënyre që të ketë shkelje substanciale të procedurës penale në nenin 403 (2) KPPK atëherë kërkohet që shkelja të ndikuar apo të mundur të ndikojë në marrjen e aktgjykimit të ligjshëm apo të duhur. Gjykata e Apelit heton se shihet qarte nga Aktgjykimi i kundërshtuar se deklarata e **KV** nuk ka ndikuar në aktgjykim. **KV** ka dhënë deklaratë rreth strukturës dhe punës së bërë nga SHIK-u. Siç është deklaruar nga Trupi Gjykoës në Aktgjykimin e kundërshtuar, involvimi i mundshëm i SHIK-ut në veprat penale ka qene relevant vetëm për të përcaktuar një motiv të mundshëm dhe motivi është diçka tjetër nga qëllimi. Se a ka qene SHIK-u i involvuar në ndonjë mënyre në veprat penale kjo nuk ndikon në qëllimin apo në fajësinë e secilit të pandehur individualisht.

50. Në fundi Mbrojtja pretendon se janë shkelur të drejtat e saj sepse Gjykata e Qarkut nuk e ka ftuar dëshmitarin që e ka propozuar mbrojtja pas deponimit të emrit nga **KV**. Ky është një pretendim i zbehtë i mbrojtës dhe është dashur të trajtohet si i tillë. Nga procesverbali i shqyrtimit kryesor mund të lexohet se Mbrojtja ka kërkuar nga Trupi Gjykoës që *ex officio* të ftojë personin që e ka shkruar **KV** në një copë letrë dhe që atë të ja dorëzuar Prokurorisë më 20 qershor 2012. Duke supozuar që kjo është ajo që i referohet në ankese është korrekt që ky person nuk është ftuar nga Trupi Gjykoës. Se a të ftohet dëshmitari *ex officio* kjo varet tërësisht nga diskrecioni i Trupit Gjykoës. Sa i përket Gjykatës së Apelit ajo ka qene në gjendje të nxjerre nga shkresat e lëndës, kërkesa kurrë nuk është shqyrtuar nga Trupi Gjykoës i Gjykatës së Qarkut e kjo është një shkelje e të drejtave të të pandehurit. Pa marrë parasysh kësaj, shkelja e tillë e të drejtave të mbrojtjes është shkelje substanciale e vetëm të procedurës penale nëse ka ndikuar apo të mundur të ndikojë në marrjen e aktgjykimit të ligjshëm apo të duhur. Nuk është e qarte nga ankesa se kujt i referohet mbrojtja dhe është edhe më pak e paqarte se për çka është dashur të dëshmojë ky dëshmitar. Mos ftesa e këtij personi nuk ka ndikuar në marrjen e Aktgjykimit të ligjshëm dhe të duhur.

3.2. Shkelja e Ligjit Penal

51. Gjykata e Apelit heton se ka pasur shkelje te ligjit penale ne logjiken qe koha e kaluar ne paraburgim nga te pandehurit nuk është kredituar ne dënim. Gjykata e Apelit gjithashtu konkludon se ka pasur shkelje te ligjit penal kur Trupi Gjykues i Gjykatës se Qarkut e ka aplikuar nenin 30 (3) KPKSAK për te kualifikuar veprën penale si renduese për SU. Gjykata e Apelit nuk heton asnjë shkelje tjetër te ligjit penal.

52. Gjykata e Apelit se pari do te adresojë shkeljet e pretenduara nga mbrojtja. Se a ka vepruar AS ne vetëmbrojtje apo jo, kjo nuk ka ndikim apo relevancë ne përcaktimin e fajësisë ndaj te pandehurit. Te pandehurit janë shpallur fajtor për veprimet e tyre dhe për qëllimet e tyre. Meqë AS nuk është i pandehur ne këtë lende kjo nuk i takon Gjykatës se Apelit te ri-shqyrtoje fajësinë e tij.

53. Te pandehurit janë shpallur fajtor për Vrasje te Rende. Vrasje te Rende ne Tentative dhe Trupi Gjykues i Gjykatës se Qarkut ka bere reference ne dispozitiv, ne nenin 30 (1) dhe (2) te KPKSAK. Është argumentuar nga Mbrojtja se ky është një kualifikim i gabuar ligjor sepse siç duket te pandehurit janë dënuar për vrasje ‘te rregullt’ dhe për Vrasje te Rende, dhe ne këtë rast te akuzës 3 ne formën e tentimit. Gjykata e Apelit heton këtë te jete një interpretim i gabuar. Neni 30 (1) dhe (2) i LPKSAK lexon si ne vijim:

- (1) Kushdo qe privon nga jeta personin tjetër do te dënohet me se paku pese vjet burgim.
- (2) Koha e burgimit prej se paku dhjete vjet apo dënim me vdekje do te shpallet kundër :

Me poshtë vazhdon lista se në cilat raste do te shqiptohet dënimi më i lartë.

Nga leximi i ligjit është e qartë se duhet t'i referohemi të dy paragrafëve të nenit 30 sikurse ka bërë trupi gjykues. Në paragrafin 1 të pjesës *actus reus*, mund të gjendet përkufizimi i veprës penale. Paragrafi 2 liston vetëm rrethanat renduese dhe prandaj të dy paragrafët duhet të lexohen së bashku.

54. Lidhur me cilësimin juridik po ashtu është argumentuar nga mbrojtja se trupi gjykues i gjykatës së qarkut e ka cilësuar në mënyrë të paligjshme veprën penale si krim i organizuar. Gjykata e apelit gjen qartë se veprat penale nuk janë cilësuar ligjërisht si krim i organizuar. Trupi gjykues gjatë vendosjes mbi dënimin ka marrë parasysh si rrethanë renduese atë se krimet janë kryer në mënyrë të organizuar. Kjo nuk do të thotë në asnjë mënyrë se krimet janë ri-cilësuar si vepër e ndarë penale e krimit të organizuar, gjë që është përmendur nga trupi gjykues në aktgjykimin e kundërshtuar. Çfarëdo pretendimi për ri-cilësim është qartë i papabuar.

55. Gjykata e Apelit gjen se ka pasur shkelje të ligjit penal për shkak se koha të cilën të pandehurit e kanë kaluar në paraburgim nuk është përfshirë në dënim. Periudha e kohës së kaluar

në mbajtje (në paraburgim) gjatë kohës së pritjes së shqyrtimit gjyqësor si dhe çdo privim i lirisë që lidhet me veprimin penal duhet, sipas nenit 50 të KPRSFJ, të llogaritet si pjesë e dënimit të burgimit. Një dispozitë e njëjtë mund të gjendet në KPK, neni 73. Mos përfshirja e kohës së kaluar në paraburgim është shkelje e ligjit penal e që sipas nenit 404 (6) të KPPK është bazë për ankesë. Vetëm të pandehurit **DH**, **SS** dhe **BS** e kanë përdorur këtë bazë për ankesat e tyre. Megjithatë bie brenda rishikimit *ex officio*, gjykata e apelit do të kryej këtë sipas nenit 415 (4) të KPPK. Prandaj aktgjykimi i kundërshtuar duhet të ndryshohet lidhur me të gjithë pesë të pandehurit në mënyrë që koha e kaluar në paraburgim të llogaritet në dënim.

56. Më tutje gjykata e apelit gjen se ka pasur shkelje të ligjit penal lidhur me cilësimin juridik të veprave penale të kryera nga **SU**. Trupi gjykues i gjykatës së qarkut ka gjetur **SU** fajtor për Vrasje të rëndë dhe Vrasje të rëndë në tentativë. Nga arsyetimi i aktgjykimit të kundërshtuar mund të nxjerrët si përfundim se si rrethanë rënduese e cila është përdorur për të cilësuar veprat penale si të rënda trupi gjykues ka konsideruar se **SU** është shpallur fajtor për të dy veprat penale. Trupi gjykues ka zbatuar nenin 30 (3) të LPKSAAK (njëjtë si neni 147 (11) dhe (12) të KPK). Gjukata e Apelit gjen se kjo është e paligjshme.

57. Neni 30 (3) LPKSAAK lexon si në vijim:

- (3) Dënimi sipas paragrafit 2 të këtij neni do të shqiptohet ndaj personit i cili ka kryer disa vrasje të paramenduara, (...) duke shpërfillur faktin se ai është duke u gjykuar për të gjitha vrasjet me zbatimin rregulloreve lidhur me bashkimin e veprave penale apo faktin se më herët ai ishte dënuar për vrasje tjetër.

Gjukata e apelit gjen se përdorimi i fjalës *duke shpërfillur* është disi ngatërrues dhe i pavend. Një dispozitë e ngjashme mund të gjendet në Kodin penal të Republikës Socialiste të Serbisë (Nr. 26/77) i ndryshuar në vitin 1977 në të cilin thuhet “Dënimi nga paragrafi 2 i këtij neni do të shpallet ndaj personit i cili me paramendim ka kryer disa vrasje (...) pavarësisht asaj nëse ata janë duke u gjykuar për të gjitha vrasjet duke aplikuar dispozitat mbi bashkimin e veprave penale ose nëse ata janë dënuar më herët për një vrasje të caktuar.

58. Përdorimi i fjalës *pavarësisht* e bën leximin e nenit të qartë dhe kjo më tej sqarohet në një nga komentaret e kodit të vitit 1981³:

11. *Paragrafi 3* parashih dënimin për kryerësin i cili ka kryer disa vrasje me paramendim , (...), pavarësisht nëse kryerësi është duke u gjykuar: a) për vrasje të kryer me zbatimin e dispozitës mbi bashkimin e veprave penale ose b) për vrasjet për disa nga të cilat ai është dënuar më përpara.⁴

³ SRZENTIC, Nikola – STAJIC, dr. Aleksandar – KRAUS dr. BOZIDAR – LAZAREVIC, dr. Ljubisa-DJORDJEVIC, dr. Miroslav, KOMENTARI MBI LIGJTE PENALE TË RS TË SERBISË, KSA KOSOVË DHE KSA VOJVODINË 1981. “SAVREMENA ADMINISTRACIJA” BEOGRAD

⁴ Faqe 56, versioni anglisht.

Qasja e gjykatës së apelit është se neni 30 (3) i LPKSAK duhet të lexohet në këtë mënyrë dhe se neni është i zbatueshëm vetëm në këto dy raste. **SU** nuk ka qenë i dënuar më përpara për vrasje dhe gjykata e apelit gjen se nuk ka bazë ligjore për interpretimin e fjalës *më përpara* për të përfshirë dënimet në të njëjtën lëndë penale. Përkundrazi komentari i përmendur më lartë i vitit 1981 e qartëson gjykimin e recidivistit si “gjykimi i personit i cili gjykohet për vrasje të paramenduar i cili tashmë është dënuar për vrasjen e tillë”.⁵

59. Me interpretimin e kuptuar nga gjykata e apelit neni 30 (3) i LPKSAK mund të zbatohet ndaj **SU** vetëm nëse dy veprat penale janë kryer në bashkim kriminal. Bashkimi kriminal është qartësuar në komentaret e mëvonshëm të kodit të vitit 1995 si *bashkim ideal kriminal* (kur pasoja ndodhë si rezultat i një veprimi të vetëm) ose *bashkim real kriminal* (si rezultat i disa veprimeve individuale).⁶ Është e qartë se dy veprat penale të **SU** nuk ishin rezultat i një veprimi të vetëm sikurse në bashkimin kriminal ideal. Nocioni i bashkimit real kriminal ka nevojë megjithatë për disa sqarime të mëtutjeshme dhe lidhur me këtë gjykata e apelit i referohet sqarimit të dhënë nga TPNJ:

“Bashkimi real kriminal” ndodh kur kryerësi kryen disa krime, ndonëse në një veprim të vetëm, ose duke shkelur dispozitën e njëjtë penale kundër më shumë se një personi ose duke shkelur një numër të veçantë të dispozitave përmes veprimeve të ndryshme. (...). Meqë ky është një koncept i njohur shumë mirë në të drejtën civile shtetet dhe shembujt shumëfishohen në precedente, gjykata do të përmend, si një shembull të një nënkllase të mëparshme, kryerja e më shumë se një vrasje duke vrarë disa persona në një breshëri zjarri; një shembull i kësaj të fundit do të ishte ngasja e pakujdesshme dhe mosdhënia e ndihmës personit të lënduar si rezultat i ngasjes së pakujdesshme, ku ekzistojnë veprime të ndryshme të ngasjes së pakujdesshme dhe e mos ndalimit pas përplasjes me dikë, duke qenë në dijeni për këtë.⁷

60. Gjukata e Apelit gjen se neni 30 (3) i LPKSAK nuk është i zbatueshëm ndaj **SU** meqë nuk ka lidhje në mes dy veprave penale dhe me përkufizimin e bashkimit kriminal të përmendur më lartë nuk mund të thuhet se krimet janë kryer në bashkim kriminal. Neni 30 (3) i LPKSAK është zbatuar nga trupi gjykues i gjykatës së qarkut, duke përbërë shkelje të ligjit penal sipas nenit 404 (4) të KPPK. Shkelja e ligjit penal duhet korrigjohet *ex officio* nga Gjukata e Apelit, në pajtim me nenin 415 (1) të KPPK. Prandaj dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar duhet të ndryshohet ashtu që të mos përfshijë referimin në nenin 147 (11) të KPK (nuk i është referuar nenit 30 (3) të LPKSAK në dispozitiv). Megjithatë, kjo nuk do të ndryshojë cilësimin juridik të veprave penale të **SU** meqë gjykata e apelit gjen se ekzistojnë bazat tjera për cilësimin e veprave penale si të rënda, të cilat do të shtjellohen më poshtë.

⁵ Faqe 57, versioni anglisht.

⁶ SREZENTIC NIKOLA – LJUBISA LAZAREVIC, KOMENTARI I KODIT PENAL TË SERBISË, 1995, EDICIONI I 5-të, “SAVREMENA ADMINISTRACIJA” BEOGRAD, faqe 24, versioni anglisht.

⁷ IT-95-16-T, Kupreskic et al, para 661.

3.3. Vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike

61. Gjykata e Apelit pajtohet me gjendjen faktike të vërtetuar nga trupi gjykues i gjykatës së qarkut. Gjykata gjen se është provuar se më 6 gusht 1999 të pandehurit **SA**, **SU** dhe **BS**, në bashkëkryerje me njëri tjetrin dhe me **NB**, kanë vrarë **IK** siç përshkruhet në aktgjykimin e kundërshtuar. Vrasja është bërë me paramendim të qartë; të pandehurit kanë vepruar si grup dhe kanë planifikuar vrasjen shumë kohë më përpara. Vrasja është kryer në prani të gruas së viktimës në shtëpinë e tij pasi të pandehurit kanë bindur gruan në mënyrë mashtruese që ajo të sjellë burrin e saj. Të gjithë këta faktorë përbëjnë vrasje të kryer në mënyrë tinëzore dhe prandaj vepra cilësohet si Vrasje të Rëndë.

62. Gjykata e apelit më tej gjen se është provuar se më 12 qershor 2000 të pandehurit **SU**, **DH** dhe **SS**, duke vepruar në bashkëkryerje me njëri tjetrin dhe me **NB**, kanë tentuar të vrasin **AS** siç përshkruhet në aktgjykimin e kundërshtuar. Tentim vrasja ka qenë mirë e organizuar dhe e planifikuar shumë kohë më herët. Vrasja ishte planifikuar të ndodhë afër shtëpisë së viktimës derisa ai ka qenë i ulur në veturën e tij, duke i dhënë atij pak mundësi të shpëtojë. Bazuar në këtë gjykata e apelit pajtohet me trupin gjykues të gjykatës së qarkut e cila gjeti se vepra penale është vrasje e rëndë në tentativë.

63. Gjykata e apelit gjen se të gjitha pikat kryesore të aktakuzës janë mbështetur me provat e paraqitura. Gjykata gjen dëshminë e **NB** të qëndrueshme, të detajuar, kredibile dhe logjike, pa ndonjë kundërthënie domethënëse. Gjykata gjen se ka shumë pak gjasa që një person i cili nuk ka qenë i pranishëm do të ishte në gjendje të jep shpjegim të tillë në detaje sikurse ka bërë **NB**. Akuza 1 mbështetet me dëshminë e **DK** dhe **AK** dhe akuza 3 mbështetet me dëshminë e dëshmitarit **AS**. Të dy akuzat mbështeten po ashtu nga dëshmitë e **MI** dhe **ST**. Ekzistojnë disa mospërputhje në mes shpjegimeve të **NB** dhe atyre të dëshmitarëve tjerë. Këto janë analizuar në detaje nga trupi gjykues i gjykatës së qarkut dhe gjykata e apelit pajtohet me analizën e tyre duke i kushtuar vëmendje të posaçme kohës së gjatë që kishte kaluar nga kryerja e krimeve.

64. Në fund gjykata e apelit gjen provat kundërthënëse, në veçanti dëshmitarët e alibisë, të pabesueshme. Në rastet e **SS** dhe **SU** alibitë janë trillime të qarta dhe në rastin e **SA** alibia është e paverifikueshme. Nuk është verifikuar se festa për të birin e **SA** ka ndodhur më 6 gusht 1999 meqë asnjë nga dëshmitarët nuk ka dhënë ndonjë shpjegim të besueshëm se pse ishin në gjendje të mbajnë në mend datën e saktë të festës.

3.4. Vendimi mbi dënimin

65. Gjatë vendosjes mbi dënimin trupi gjykues, sipas nenit 64 të KPK, ka konsideruar rrethanat rënduese dhe lehtësuese, mos të ngatërrohet me rrethanat rënduese të cilat janë marrë parasysh për cilësimin e veprës penale si të rëndë.

66. Trupi gjykues i gjykatës së qarkut ka marrë parasysh çështjet e ngritura në nenin 64 të KPK dhe gjykata e apelit pajtohet plotësisht me gjetjet e saj përsa i përket rrethanave rënduese dhe lehtësuese. Nuk është ngritur asnjë argument në ankesë lidhur me rrethanat rënduese apo lehtësuese. Gjykata e apelit gjen dënimin e shqiptuar të arsyeshëm dhe proporcional. Prandaj për këtë pjesë ankesat refuzohen si të pabazuara. Siç u arrit në përfundim tanimë nga gjykata e apelit koha e kaluar në paraburgim do të llogaritet në dënime dhe ankesat në emër të të pandehurve **DH**, **SS** dhe **BS** pranohen lidhur me këtë pjesë.

67. Përsa i përket **SU** është sugjeruar nga prokurori i apelit se si rrethanë rënduese gjatë vendimit mbi dënimin trupi gjykues i gjykatës së qarkut ka zbatuar nenin 30 (3) të LPKSAK. Gjykata e apelit nuk pajtohet me këtë interpretim të aktgjykimit. Duke lexuar aktgjykimin e kundërshtuar është e qartë se neni 30 (3) i LPKSAK është zbatuar për të vërtetuar rrethanën rënduese në *cilësimin* veprës penale si të rëndë, nuk është zbatuar si rrethanë rënduese gjatë vendosjes mbi dënimin. Rrethana e njëjtë rënduese nuk mund të përdoret edhe për të cilësuar veprën penale edhe për të vendosur mbi dënimin pasi që kjo do të nënkuptonte se të pandehurit do t'i rritej dënimi dy herë. Gjykata e apelit ka vendosur të ndryshojë aktgjykimin e kundërshtuar ashtu që të mos cilësojë veprat penale si të rënda mbi bazat e nenit 30 (3) të LPKSAK. Veprat penale megjithatë cilësohen si të rënda mbi bazën e nenit 30 (2) të LPKSAK. Prandaj, gjykata e apelit nuk gjen baza për ndryshimin e dënimit të shqiptuar meqë gjykata gjen se trupi gjykues i gjykatës së qarkut ka shqiptuar dënime të duhura për të dy veprat penale gjithashtu dhe dënimin unik.

4. Përfundim

68. Në përfundim gjykata e apelit gjen se ankesat e ushtruara në emër të **DH**, **BS** dhe **SS** janë pjesërisht të bazuara lidhur me llogaritjen e kohës së kaluar në paraburgim. Ankesat janë të pabazuara në të gjitha bazat tjera. Më tej gjykata e apelit gjen se ka pasur shkelje të ligjit penal sepse trupi gjykues i gjykatës së qarkut ka zbatuar nenin 30 (3) të LPKSAK kur ka cilësuar veprat penale të **SU** si të rënda. Prandaj ka vendosur sikurse në dispozitiv.

Kryetar

Annamarie Meister

Gjykatëse e EULEX-it

Anëtar i kolegjit

Anëtari i kolegjit

Procesmbajtës

Bertil Ahnborg

Xhevdet Abazi

Anna Malmström

Gjykatës i EULEX-it

Gjykatës

Zyrtare Juridike e EULEX-it

Përgatitur në gjuhën angleze, gjuhë e autorizuar. Aktgjykimi me arsyetim i kompletuar dhe nënshkruar më 21 shkurt 2014.